

Nazlije Qerimi, candidate MR¹

UDC: 332.1(497.7):339.727.22(4-672EU)"2007/2025"

**ROLI, NDIKIMI DHE NDARJA E FONDEVE IPA NË NIVEL
REPUBLIKAN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT
(2007-2027)**

**УЛОГАТА, ВЛИЈАНИЕТО И РАСПРЕДЕЛБАТА НА ИПА-
ФОНДОВИТЕ НА РЕПУБЛИЧКО НИВО ВО РЕПУБЛИКА
СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА (2007–2027)**

**THE ROLE, IMPACT AND DISTRIBUTION OF IPA FUNDS AT THE
NATIONAL LEVEL IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA
(2007-2027)**

Abstract

This paper explores the allocation, utilization, and implementation of IPA funds in North Macedonia, from the initial access to these funds up to the year 2027.

It begins with a brief overview of the European Union and the mechanisms through which financial assistance is provided to candidate countries. The focus then shifts to the IPA funds: what these funds are, explaining each phase and subsequently analyzing IPA I, IPA II, and IPA III.

A dedicated section is assigned to the IPARD funds, aimed at rural development and agriculture.

Financial allocations for IPARD I, II, and III during the period 2007 to 2027 are presented.

The paper also reviews the regional distribution of EU funds in North Macedonia from 2007 to 2025, highlighting differences between

¹ Autorja është në fazën përfundimtare të ciklit të dytë të studimeve master në Universitetin e Tetovës, Fakulteti i Administratës së Biznesit, Programi Studimor i Administratës Publike. Email: n.qerimi233058@unite.edu.mk

regions, where the Vardar region has received the most funds, while the Polog region has benefited the least.

This paper covers all funds, including IPA and IPARD, allocated by the EU to North Macedonia over a long period, demonstrating their significant impact and showing the important role played by the European Union.

Keywords: *IPA, European Union, funds, regions, IPARD, North Macedonia, development policy, financing.*

I. Hyrje

Fondet IPA përbëjnë mekanizmin kryesor financiar që Bashkimi Evropian u ofron vendeve kandidate dhe atyre potenciale për anëtarësim. Këto fonde kanë për qëllim të mbështesin reformat politike, ekonomike dhe institucionale, duke u dhënë vendeve përfituese mundësinë të afrohen më shumë me standardet dhe praktikat evropiane. Përmes investimeve në fusha si sundimi i ligjit, zhvillimi rajonal, bujqësia, infrastruktura dhe shoqëria civile, IPA ndihmon në përgatitjen graduale të këtyre shteteve për anëtarësimin e plotë në BE.

Bashkimi Evropian është familje e shteteve demokratike evropiane që punojnë së bashku për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj dhe për të ndërtuar një botë më të mirë.² Në rrethin e BE-së janë shtetet anëtare, 28 vendet që i përkasin Unionit dhe qytetarëve të tyre.³ Procesi i integritimit në BE ka një impakt shumë të madh në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Sidoqoftë, ky impakt është më i dukshëm në nivel vendor dhe është pikërisht pushteti lokal ai që ka një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e zbatimit në mënyrë të duhur të legjislacionit dhe politikave të BE-së.⁴ Qëllimi i fondeve IPA është të mbështesin vendet në tranzicionin e tyre të kalimit nga vende kandidate potenciale në vende kandidate dhe më pas në vende anëtare të BE-së.⁵

² Komisioni Evropian, “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Zyra për publikime zyrtare të Komuniteteve Evropiane, Bruksel 2007. (accessed 09.09.2025).

³ Bashkimi Evropian, Si funksionon Bashkimi Evropian, Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, Belgjikë, 2014, f. 6. (accessed 09.09.2025).

⁴ Komisioni Evropian, “Legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe Qeverisja Vendore në Shqipëri”, Tiranë, 2019, f. 8. (accessed 10.09.2025).

⁵ Le të flasim për Fondet IPA II: Udhëzues për Organizatat e Shoqërisë Civile. Linku: <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2013/09/toolkit-IPA-II-AL.pdf> (accessed 11.09.2025)

Në përfundim, mund të thuhet se fondet IPA përfaqësojnë një instrument kyç të Bashkimit Evropian për të mbështetur vendet kandidate dhe ato potenciale në rrugëtimin e tyre drejt anëtarësimit. Megjithatë, suksesi i këtyre fondeve varet nga menaxhimi i tyre, transparenca se si do të ndahen këto fonde në vend, sepse BE jo vetëm që ndihmon për përafrimin drejt saj, por ndihmon edhe në zhvillimi e demokracisë dhe stabilitet rajonal.

II. Çfarë janë fondet IPA

Instrumenti i Ndihmës për Para-Anëtarësim (IPA) është mekanizmi përmes të cilit Bashkimi Evropian mbështet që prej vitit 2007 reformat në rajonin e zgjerimit, duke ofruar ndihmë financiare dhe teknike. Fondet e IPA-s synojnë forcimin e kapaciteteve të vendeve përfituese gjatë gjithë procesit të anëtarësimit, duke sjellë zhvillime progresive dhe pozitive në rajon.⁶

IPA është krijuar në vitin 2007 dhe aktualisht ndodhet në ciklin e tij të tretë, duke mbështetur vendet e zgjerimit të BE-së për realizimin e reformave politike dhe ekonomike gjatë gjithë procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.⁷

IPA është mekanizmi i krijuar nga BE-ja për të shpërndarë ndihmën në mënyrë efikase në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Nevojat ndryshojnë midis vendeve kandidate, Turqisë, Kroacisë dhe Maqedonisë dhe vendeve potencialisht kandidate, Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë.⁸

II. 1. Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit - I - gjatë periudhës 2007-2013

Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit është një linjë financiare, buxhetore e Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. Instrumenti i Para-Aderimit është instrumenti i ri financiar, i themeluar me Rregulloren e Këshillit (EC).⁹ Për periudhën

⁶ The Instrument for Pre-accession Assistance.

Linku: https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en (accessed 12.09.2025).

⁷ The IPA CARE Programme.

Linku: <https://www.ipacare.eu/programme/funding/> (accessed 12.09.2025).

⁸ European Commission, "Instrument for Pre-accession Assistance IPA", A new focus to EU Assistance for Enlargement, Belgium, 2009. (accessed 13.09.2025).

⁹ Rregullorja (EC); No. 1085/2006. Për themelimin e Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA). Linku: http://europa.rs/upload/documents/l_21020060731en00820093.pdf. (accessed 13.09.2025).

2007-2013 në kuadër të kësaj ndihme janë ndarë 11.5 miliardë euro. Ky program synon që përmes dhënies së asistencës vendeve kandidate dhe kandidate potenciale të ndikojë në harmonizimin dhe zbatimin e Acquis communautaire ashtu siç përgatit këto vende për të përfituar në të ardhmen nga fondet strukturore të Bashkimit Evropian.¹⁰

Sipas bazës ligjore të Bashkimit Evropian, çdo vend i kontinentit evropian që i plotëson kriteret sipas nenit 6 dhe nenit 49 të Traktatit të BE-së mund të aplikoj për t'u anëtarësuar në BE.¹¹

Pesë komponentët përbërëse të IPA-s janë:

- ❖ Ndihma për tranzicionin dhe ndërtimin e institucioneve
- ❖ Bashkëpunimi ndërkufitar
- ❖ Zhvillimi rajonal
- ❖ Zhvillimi i burimeve njerëzore
- ❖ Bujqësia dhe zhvillimi rural.¹²

Në tabelën në vazhdim do të paraqiten fondet IPA të ndara për Maqedoninë e Veriut nga viti 2007 deri në vitin 2013, sipas komponentëve përkatës.

Tabela 1. Ndarja dhe realizimi i fondeve IPA - I - për Republikën e Maqedonisë së Veriut

IPA Komponentët	Ndarë (euro)	Kontraktuar	Përqindja	Paguar	Përqindja
I	244.112.110	91.878.188	38 %	63.390.658	26 %
II	46.665.771	21.222.005	45 %	14.650.282	31 %
III	200.426.454	55.846.836	28 %	2.769.394	1 %
IV	40.8555.644	10.252.020	25 %	4.000.950	10 %
V	82.828.629	7.766.905	9 %	4.999.999	6 %
Totali	614.888.608	186.965.954	30 %	89.811.284	15 %¹³

Në bazë të të dhënave të marra nga literatura përkatëse, ne mund të shpjegojmë se në periudhën 2007-2013, Bashkimi Evropian ndau për Republikën e Maqedonisë mbi 614 milionë euro nga fondet e Instrumentit të Para-Anëtarësimit. Qëllimi i këtyre fondeve ishte mbështetja e reformave institucionale, zhvillimit rajonal, përmirësimit të resurseve

¹⁰ European Commission, "Overview - Instrument for Pre-accession Assistance". Linku: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en (accessed 14.09.2025)

¹¹ Neni 6 i Traktatit të Bashkimit Evropian. Linku: <http://www.leforum.de/de/maastrichtde.pdf> (accessed 20.05.2024).

¹² IPA2007.

Linku: https://www.dei.gov.ba/en/instrument-for-pre-accession-assistance?utm_source (accessed 15.09.2025)

njerëzore dhe modernizimit të bujqësisë. Megjithatë, nga kjo shumë e konsiderueshme vetëm 186 milionë euro (30%) arritën të kontrahohen në projekte konkrete. Dhe vetëm 89 milionë euro (15%) u kthyen në investime të prekshme. Kjo tregon një shkallë shumë të ulët të realizimit të fondeve në krahasim me potencialin që kishte vendi.

Arsyet kryesore që raportohen për këtë nivel të ulët shfrytëzimi lidhen me mungesën e kapaciteteve administrative për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve, procedurat komplekse burokratike dhe vonesat institucionale, vështirësitë në implementimin e projekteve të mëdha infrastrukturore.

Pasojat e këtij realizimi të ulët janë të qarta. Maqedonia humbi një mundësi të rëndësishme për të financuar projekte zhvillimore, duke mbetur prapa në krahasim me disa vende të tjera të rajonit që arritën të shfrytëzojnë më me efikasitet fondet IPA. Mesazhi kryesor është se, ndonëse fondet e BE-së ishin të mëdha, vendi arriti të shfrytëzojë vetëm një pjesë të vogël të tyre. Kjo nënvizon nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e menaxhimit, në mënyrë që programet pasuese të mos humbasin, por të shndërrohen në zhvillim real për vendin.

II. 2. Instrumenti për Ndihmën Para-Anëtarësimin - II - periudha 2014-2020

Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimin (IPA II) është instrumenti kryesor financiar për të ofruar mbështetje të BE-së për vendet përfituese në zbatimin e reformave në funksion të anëtarësimin në Bashkimin Evropian.¹³ Komisioni përcaktoi kuadrin për instrumentet e Bashkimit Evropian për financimin e veprimeve të jashtme, përfshirë edhe Instrumentin për Ndihmën Para-Anëtarësimin.¹⁴ IPA II ndihmon vendet që janë kandidatë ose potencialisht kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian që të përshtatin sistemet e tyre ligjore dhe ekonomike në mënyrë që të kualifikohen për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian. Për të përmbushur procesin e integritetit, vendet kandidatë duhet të plotësojnë atë që quhet kriteret e Kopenhagës.¹⁵

¹³ European Commission, Instrument for Pre-Accession Assistance, "Multi-Country Indicative Strategy Paper", 2014-2020, f. 3. (accessed 17.09.2025).

¹⁴ European Parliament and Council of the EU, Regulation (EU) No 231/2014 of the European Parliament and of the Council of 11 March 2014 establishing an Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II), *Official Journal of the European Union*, L 77, 15 March 2014, 11–26. Linku: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32014R0231> (accessed 18.09.2025).

¹⁵ European Parliament, Briefing: "How the EU budget is spent", June, 2017, faqe 2. (accessed 19.09.2025).

IPA II synon reformën në kuadrin e sektorëve të përmendur më parë, të cilët përfshinin fusha ngushtësisht të lidhura me strategjinë e zgjerimit, si demokracia dhe qeverisja, sundimi i ligjit, rritja ekonomike dhe konkurrueshmëria.¹⁶ Kjo metodë lejoi një ndihmë më të targetuar, duke siguruar efikasitet, qëndrueshmëri dhe fokus te rezultatet, gjithashtu mundësoi përdorim më sistematik të mbështetjes përmes buxhetit sektorial dhe i dha më shumë rëndësi matjes së performancës, treguesit e dakorduar me përfituesit ndihmuan në vlerësimin e shkallës së arritjes së rezultateve të pritshme.¹⁷

Në tabelën në vijim do të paraqiten fondet IPA të ndara për Maqedoninë e Veriut gjatë periudhës 2014-2020 të strukturuar.

Tabela 2. Ndarja e fondeve IPA - II - nga Bashkimi Evropian për Maqedoninë e Veriut 2014-2020

Republika e Maqedonisë së Veriut	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Totali 2018- 2020	Totali 2014- 2020	%
Demokracia dhe Shteti i së Drejtës	39.7	15.8	24.4	24.6	37.9	5.8	39.6	83.3	187.8	
Demokracia dhe Qeverisja	19.7	15.8	9.8	24.594	36.5	4.4	20.2	61.1	130.9	
Shteti i së Drejtës dhe të Drejtat	20.0	0.0	14.6	0.0	1.4	1.4	19.5	22.3	56.9	
Konkurrueshmëria dhe Rritja	42.0	51.4	40.2	57.6	69.8	115.6	44.4	229.8	421.0	
Mjedisi, Veprimi për Klimën	15.0	18.4	11.0	16.6	27.6	10.4	24.2	62.2	123.3	100%
Transport	4.0	14.7	18.2	11.2	29.4	35.4	2.3	67.1	115.2	60%
Konkurrueshmëria, Inovacioni, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	23.0	18.3	11.0	6.0	11.4	49.4	16.5	77.3	135.6	10% ¹⁹
Arsimi, Punësimi dhe Politikat Sociale	0.0	0.0	0.0	23.7	1.4	20.4	1.5	23.3	47.0	
TOTALI	81.7	67.2	64.6	82.2	107.7	121.4	84.0	313.1	608.7	

Linku: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2017/603957/EPRS_BRI\(2017\)603957_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2017/603957/EPRS_BRI(2017)603957_EN.pdf) (accessed 19.09.2025).

¹⁶ Ibid

¹⁷ The Instrument for Pre-accession Assistance (IPA). Linku: https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en?prefLang=fr (accessed 20.09.2025).

Sipas literaturës së shfrytëzuar dhe të dhënave të paraqitura, gjatë periudhës 2014-2020, Maqedonia e Veriut ka përfituar rreth 608 milionë euro nga fondet IPA, me fokus kryesor në konkurrueshmëri dhe zhvillim ekonomik, forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, si dhe qeverisjen demokratike.

Megjithatë, problemi kryesor nuk qëndron në mungesën e fondeve, por në mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Edhe pse janë investuar mjete të konsiderueshme, besueshmëria e institucioneve, veçanërisht gjyqësorit, mbetet shumë e ulët, me vetëm rreth 2% të qytetarëve që shprehin besim në sistemin e drejtësisë. Kjo tregon se reformat nuk kanë sjellë rezultate të qëndrueshme dhe se efektiviteti i përdorimit të fondeve nuk është reflektuar në përmirësimin real të qeverisjes dhe sundimit të ligjit.

Prandaj, Maqedonia e Veriut duhet të përqendrohet në përdorimin më efikas dhe të qëndrueshëm të fondeve të BE-së.

Mungesa e transparencës mbetet një shqetësim serioz, pasi raportet tregojnë se një pjesë e madhe e fondeve nuk është përdorur në mënyrën e duhur. Rritja e llogaridhënies dhe forcimi i kapaciteteve administrative janë hapa të domosdoshëm për të siguruar që ndihma financiare të kthehet në përmirësime reale për qytetarët dhe në përparim të procesit të integritetit evropian.

III. Instrumenti për Ndihmën Para-Anëtarësimi - III - periudha 2021-2027

IPA III është një instrument për Ndihmën Para-Anëtarësimi i Komisionit Evropian për periudhën programore 2021–2027. Ky instrument prezantohet me çdo perspektivë të re financiare të Bashkimit Evropian.¹⁸ Për të siguruar zbatimin e planit shumëvjeçar të veprimit në favor të Ballkanit Perëndimor për periudhën 2025–2027, është e nevojshme të miratohet një vendim shumëvjeçar për financimin, i cili do të përbëjë programin shumëvjeçar të punës për këtë periudhë. Pesë komponentët e IPA - III janë:

- ❖ Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia
- ❖ Mirëqeverisja dhe përafrimi me legjislacionin e BE-së
- ❖ Agjenda e gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme

¹⁸ IPA 2021-2027, Ministria për Çështje Evropiane e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Linku: <https://mep.gov.mk/en-GB/fondovi/ipa-2021-2027> (accessed 22.09.2025).

- ❖ Rritja konkurruese dhe gjithëpërfshirëse
- ❖ Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar.¹⁹

Në tabelën në vazhdim do të paraqiten fondet IPA të ndara për Maqedoninë e Veriut prej vitit 2021 deri në vitin 2027 do të thotë ndarjet vjetore.

Tabela 3. Ndarja e fondeve IPA nga Bashkimi Evropian për Maqedoninë e Veriut 2021-2027

	%	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	Totali
Sundimi i ligjit, të drejtat themelore	15.13	281	281	287	292	298	304	310	2.089
Qeverisja e mirë, përafrimi me acquis e BE	16.59	308	308	314	321	327	333	340	2.291
Agjenda e gjelbër dhe lidhja qëndrueshme	42.25	788	788	804	820	837	853	870	5.860
Rritja konkurruese dhe gjithëpërfshirëse	22.31	414	414	422	431	440	448	457	3.080
Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar	3.51	65	66	66	68	69	71	72	485
Totali i Buxhetit Operacional	100.0	1.855	1.894	1.894	1.932	1.971	2.010	2.051	13.804
Shpenzimet Administrative	n/a	49	49	49	50	51	52	53	357
Totali	100.00 %	1.904	1.943	1.943	1.982	2.022	2.062	2.104	14.162 ¹

Në bazë të të dhënave të marra nga literatura përkatëse, ne mund të shpjegojmë se nga të dhënat e paraqitura për programin IPA III, shihet qartë se pjesa më e madhe e mjeteve është përqendruar në Agjendën e gjelbër dhe lidhjen e qëndrueshme, si dhe në rritjen konkurruese dhe gjithëpërfshirëse.

Këto prioritetë pasqyrojnë orientimin e Bashkimit Evropian drejt tranzicionit të gjelbër, zhvillimit të qëndrueshëm dhe forcimit të kapaciteteve ekonomike të vendit.

¹⁹IPA III. Linku: <https://www.dei.gov.ba/en/ipa-iii> (accessed 23.09.2025).

Nga ana tjetër, mbështetje e konsiderueshme u dedikohet edhe qeverisjes së mirë dhe përafrimit me *acquis* të BE-së dhe sundimit të ligjit e të drejtave themelore, duke theksuar rëndësinë e reformave institucionale dhe demokratike.


Fusha të tjera si bashkëpunimi territorial dhe ndërkulturor dhe shpenzimet administrative zënë një peshë më të vogël në shpërndarjen totale.

Në përgjithësi, buxheti i IPA III është ndërtuar për të balancuar reformat institucionale me investimet zhvillimore, duke krijuar një qasje gjithëpërfshirëse që synon njëkohësisht forcimin e shtetit ligjor dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik e mjedisor duke shpresuar që mos të kemi stagnim.

IV. Shpërndarja e fondeve evropiane në Maqedoninë e Veriut (2007-2025)

Që nga viti 2007, Maqedonia e Veriut ka përfituar fonde të konsiderueshme nga Bashkimi Evropian nëpërmjet instrumenteve të paraanëtarësimit.²⁰ Shuma e përgjithshme e ndarë për periudhën 2007–2025 arrin 812.457.807.62 euro.²¹

Grafiku 1. Shpërndarja e fondeve sipas rajoneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut



²⁰ Burimi i të dhënave: Sekretariati për Çështje Evropiane i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Linku: <https://zk.mk/sekretariati-per-ceshtje-evropiane?lang=sq> (accessed 26.09.2025)

²¹ European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of Regions, Brussels, 2024. Linku: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf (accessed 27.09.2025).

Të dhënat statistikore janë marrë nga burime të caktuara, por janë përpunuar në grafikë, analizuar dhe interpretuar nga vetë autorja e punimit.

Në bazë të të dhënave të marra nga literatura përkatëse, ne mund të shpjegojmë se nga të dhënat e përpunuara vërehet se shpërndarja e fondeve evropiane në Maqedoninë e Veriut nuk ka qenë e balancuar midis rajoneve. Rajonet si Vardari, Pelagonia dhe Shkupi kanë përfituar shuma dukshëm më të larta, ndërsa Pollogu dhe Jugperëndimi kanë mbetur prapa me mbështetje shumë më të kufizuar. Këto dallime lidhen me disa faktorë: kapacitetet më të zhvilluara administrative dhe institucionale në rajonet qendrore, përqendrimi i investimeve në infrastrukturë dhe ekonomi në qendrat urbane, si dhe ndikimet politike në ndarjen e fondeve. Si rezultat, është krijuar një perceptim për pabarazi rajonale dhe një menaxhim jo gjithmonë transparent, gjë që ndikon negativisht në besimin e qytetarëve ndaj institucioneve publike.

Për të siguruar një shpërndarje më të drejtë dhe efektive në ardhmen, nevojiten masa konkrete si: rritja e transparencës publike, kontrollimi, forcimi i kapaciteteve të komunave më të dobëta, përfshirja aktive e qytetarëve, si dhe shmangia e ndikimeve politike në procesin e vendimmarrjes.

V. Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural IPARD

IPARD paraqet qasje në fondet e Bashkimit Evropian të destinuara për ndihmë financiare për bujqësi të qëndrueshme dhe zhvillimin rural, me politikën e përbashkët bujqësore dhe politikat për një bujqësi të qëndrueshme rurale.²²

Programi IPARD I (2007-2013) u fokusua në tri masa kryesore investimesh: ristrukturimin dhe modernizimin e fermave bujqësore, investime për ristrukturimin dhe modernizimin e përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore dhe peshkimit, si dhe diversifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike rurale.²³

Programi IPARD (2014-2020) ofroi mbështetje përmes pesë masave (katër prej të cilave u zbatonin edhe në periudhën programuese 2007-2013): Investime në asete fizike të fermave bujqësore, investime në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, Investime në

²² IPARD EU4 Rural Area. Linku : <https://agencija.gov.mk/sq/ipard/> (accessed 03.10.2025).

²³ Project Planning and Management, "Ex-post Evaluation of the IPARD Programme 2007-2013 of the Republic of North Macedonia", Bulgaria, 2020, faqe 10. Linku: https://ipard.gov.mk/wp-content/uploads/2021/01/Final-Report_Ex-post-eval_-IPARD-Programme-2007-2013.pdf (accessed 04.10.2025).


infrastrukturë rurale publike, diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, asistencë teknike.²⁴

Programi IPARD-III (2021-2027) synon të mbështesë investimet në ferma bujqësore, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe peshkimit, masat agro-mjedisore, asistencë teknike etj.²⁵

V.1.Fondet IPARD të ndara për Republikën e Maqedonisë së Veriut

Fondet IPARD janë grante të BE-së për vendet kandidate, përfshirë Maqedoninë e Veriut, në fushat e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural. Që nga viti 2007 e këndej, Maqedonisë së Veriut i janë ndarë rreth 223 milionë euro fonde IPARD.²⁶

Grafiku 2. Paraqitja e fondeve IPARD të ndara nga BE për Maqedoninë e Veriut nga viti 2007-2027²⁷



²⁴ Republika e Maqedonisë së Veriut, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave – Autoriteti Menaxhues i IPARD-it, Raporti Vjetor për Zbatimin e Programit IPARD 2014–2020 për vitin 2024 dhe Raporti Përfundimtar për Zbatimin e Programit IPARD 2014–2020, Shkup, 2024, faqe 7. Linku https://ipard.gov.mk/wp-content/uploads/2025/06/IPARD-2-AIR-2024_FIR-2014-2020.pdf (accessed 05.10.2025).

²⁵ Komisioni Evropian, Vendimi Zbatues i Komisionit për miratimin e Programit për Zhvillim Rural IPARD-III të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021-2027, Bruksel, 2022, faqe 4. Linku: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/f679f019-d6d6-454e-b59f-aea1b1819929_en?filename=C_2022_1538_F1_COMMISSION_IMPLEMENTING_DECISION_EN_V4_P1_1844369.PDF (accessed 06.10.2025).

²⁶ RMV lider në rajon për shfrytëzimin e fondeve IPARD... Linku: <https://portalb.mk/rmv-ja-lider-ne-rajon-per-shfrytezim-te-fondeve-ipard-programi-i-ri-pritet-te-jep-efekte-me-te-medha-infografik/> (accessed 24.09.2025)

²⁷ Komisioni Evropian, Vendimi Zbatues i Komisionit për miratimin e Programit për Zhvillim Rural IPA III (IPARD III) për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitet 2021–2027, Bruksel, 9 mars 2022. Linku: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North%20Macedonia (accessed 25.09.2025).

Të dhënat statistikore janë marrë nga burime të caktuara, por janë përpunuar në grafikë, analizuar dhe interpretuar nga vetë autorja e punimit.

Në bazë të të dhënave të marra nga literatura përkatëse, ne mund të shpjegojmë se fondet IPARD kanë pësuar luhatje në periudha të ndryshme programore. Në periudhën IPARD I buxheti ishte 65.6 milionë €, ndërsa në IPARD II në 60 milionë €. Megjithatë, gjatë IPARD III vërehet një rritje e dukshme e fondeve në 97 milionë €, e cila reflekton një angazhim më të madh të Bashkimit Evropian për të mbështetur zhvillimin rural dhe bujqësinë në vend. Në përgjithësi, këto fonde paraqesin një mundësi të rëndësishme për modernizimin e sektorit bujqësor, rritjen e konkurrueshmërisë dhe përafrimin gradual me standardet e BE-së. Potenciali është i madh, por suksesi i tyre varet nga kapaciteti i institucioneve dhe i përfituesve për t'i menaxhuar dhe përdorur në mënyrë efikase dhe transparente. Prandaj, programet IPARD mund të konsiderohen jo vetëm si një mundësi zhvillimi, por edhe si një test i rëndësishëm institucional për të vlerësuar gatishmërinë e Maqedonisë së Veriut drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Recensentë:

Doc. dr. Iljaz Ameti

Pr. mr. Muhamer Pajaziti (PhD Cand)

Conclusions

The analysis of the allocation and utilization of IPA funds in North Macedonia demonstrates that, although these funds represent one of the most significant sources of financial support for candidate countries, the results achieved so far remain below expectations. The experience with IPA I, IPA II, and IPA III shows that a considerable share of the funds has either not been absorbed or has been returned, largely due to limited administrative capacities, insufficient planning, and challenges in project implementation. Moreover, the regional analysis highlights a serious issue regarding transparency and equity in fund distribution, as regions with the greatest need for support often benefit the least, thereby remaining excluded from key development processes. This not only deepens regional disparities but also slows down the country's overall progress on its path toward European integration.

In this context, enhancing transparency in the allocation of resources, strengthening monitoring mechanisms, and building institutional capacities at both national and local levels emerge as indispensable prerequisites for increasing the efficiency of IPA funds. A fairer and more inclusive management approach would not only foster balanced regional development but also enhance citizens' trust in institutions and in the integration process itself.

In conclusion, the support of the European Union through IPA and IPARD programs remains a crucial pillar for the economic, institutional, and social development of North Macedonia. However, fully benefiting from these mechanisms requires stronger accountability, transparency, and a clear strategic vision. Accelerating the Euro-Atlantic path is therefore not merely a political choice, but a necessity to ensure stability, sustainable development, and a better future for all citizens of the country.

Literatura e shfrytëzuar

1. Komisioni Evropian, “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Zyra për publikime zyrtare të Komuniteteve Evropiane, Bruksel 2007.
2. Bashkimi Evropian, Si funksionon Bashkimi Evropian, Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, Belgjikë, 2014, faqe 6.
3. Komisioni Evropian, “Legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe Qeverisja Vendore në Shqipëri”, Tiranë, 2019, fq 8.
4. European Commission, “Instrument for Pre-accession Assistance IPA”, A new focus to EU Assistance for Enlargement, Belgium, 2009.
5. Rregullorja (EC); No. 1085/2006. Për themelimin IPA
6. Ristevska-Jordanova, Malinka “Shfrytëzimi i Fondeve të BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Instituti për Politikë Evropiane, Shkup, 2013
7. Simonida Kacarska, Riste Jurukovski, “Analysis of the Use IPA Funds”, European Policy Institute (EPI), Republic of Macedonia, Skopje, 2013, faqe 6.
8. European Commission, Instrument for Pre-Accession Assistance, “Multi-Country Indicative Strategy Paper”, 2014-2020, faqe 3.
9. European Parliament and Council of the EU, Regulation (EU) No 231/2014 of the European Parliament and of the Council of 11 March 2014 establishing an (IPA II)

10. Komisioni Evropian, Vendim Zbatues i Komisionit për miratimin e Programit për Zhvillim Rural IPA III (IPARD III) për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitet 2021–2027. Bruksel, 9 mars 2022

11. European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of Regions, Brussels, 2024.

12. European Parliament, Briefing: “How the EU budget is spent”, June, 2017, faqe 2.

13. Project Planning and Management, “Ex-post Evaluation of the IPARD Programme 2007-2013 of the Republic of North Macedonia”, Bulgaria, 2020, faqe 10.

14. Republika e Maqedonisë së Veriut, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave – Autoriteti Menaxhues i IPARD-it, Raporti Vjetor për Zbatimin e Programit IPARD 2014–2020 për vitin 2024 dhe Raporti Përfundimtar për Zbatimin e Programit IPARD 2014–2020, Shkup.

15. Komisioni Evropian, Vendimi Zbatues i Komisionit për miratimin e Programit për Zhvillim Rural IPARD-III të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021-2027, Bruksel, 2022.

16. Pr. Muhamer Pajaziti, Dispensë “Integritet Ekonomike Evropiane - Tregu i Brendshëm i BE-së”, Kolegji ISPE..

17. <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2013/09/toolkit-IPA-II-AL.pdf>

18. https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en

19. <https://www.ipacare.eu/programme/funding/>

20. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en

21. <http://www.leforum.de/de/maastrichtde.pdf>

22. https://www.dei.gov.ba/en/instrument-for-pre-accession-assistance?utm_source

23. https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance/north-macedonia-financial-assistance-under-ipa_en

24. <https://mep.gov.mk/en-GB/fondovi/ipa-2021-2027>

25. <https://portalb.mk/rmv-ja-lider-ne-rajon-per-shfrytezim-te-fondeve-ipard-programi-i-ri-pritet-te-jep-efekte-me-te-medha-infografik>
26. <https://www.dei.gov.ba/en/ipa-iii>
27. https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en
28. <https://zk.mk/sekretariati-per-ceshtje-evropiane?lang=sq>
29. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf
30. <https://agencija.gov.mk/sq/ipard>